ALBANIAN ASSOCIATION OF BANKS
SHOQATA SHQIPTARE E BANKAVE

# Shoqata Shqiptare
# e
# Bankave

# RAPORT VJETOR

# 2005

# Përmbajtja


| | |
|---|---|
| ***Mesazhi i Kryetarit*** | ***43*** |
| ***Ngjarjet e Rëndësishme*** | ***45*** |
| ***Skema Organizative e AAB-së*** | ***46*** |
| ***Komiteti Ekzekutiv & Sekretariati i AAB-së*** | ***47*** |
| ***Aktiviteti i AAB-së*** | ***49*** |
| - *Ekzekutimi i Kolateralit* | *49* |
| - *Zyra e Informacionit mbi Kreditë* | *49* |
| - *Nismat Ligjore* | *49* |
| - *Kodi i Etikës Bankare* | *50* |
| - *Promovimi & Marketingu* | *51* |
| - *Organizimet e Brendshme & Pjesëmarrjet Ndërkombëtare* | *51* |
| - *Financimi i Skemës Sociale të Strehimit* | *52* |
| - *Të Ndryshme* | *52* |
| ***Objektivat për Vitin 2006*** | ***54*** |
| ***Profili i AAB-së*** | ***55*** |
| ***Aktiviteti Financiar i AAB-së*** | ***56*** |
| ***Profili i Bankave në Shqipëri*** | ***64*** |

# Mesazhi i Kryetarit



Të dashur kolegë:

Ashtu siç e ka thënë dhe i ndjeri Mancur Olson – një teoricien i madh i logjikës së veprimit të përbashkët- vetëm një "organizatë gjithëpërfshirëse", dmth, një organizatë që përfaqëson pjesën dërrmuese të interesave ekonomike në shoqëri, mund të lobojë dhe përpiqet për politika që rrisin të ardhurat në përgjithësi, në vend të atyre që rrisin vetëm të ardhurat e anëtarëve të tyre, në dëm të interesave të të tjerëve. Kjo mund të shpjegojë gjithshashtu dhe faktin se pse unionet dhe shoqatat shpesh paragjykohen nga autoritetet. Megjithatë, ne besojmë se AAB nuk punon thjesht në dobi të anëtarëve të saj, që sigurisht nuk përfaqëson një pjesë të madhe të shoqërisë, por gjithashtu edhe në dobi të autoriteteve dhe publikut të gjërë, dhe aspak në dëm të interesave të këtyre të fundit. Ne përpiqemi ta arrijmë këtë duke i trajtuar me objektivitet çështjet që dalin, të cilat ironikisht, mbështeten deri diku nga fakti që, ambjenti financiar dhe ai bankar në Shqipëri është ende në zhvillim e sipër.

Viti 2005 rezervoi shumë ngjarje të rëndësishme, në drejtim të funksionimit dhe aktivitetit të AAB-së. Kështu, u zgjodh Komiteti i ri Ekzekutiv, i përbërë nga Drejtorët e Përgjithshëm të pesë bankave, duke përfaqësuar në mënyrë më të balancuar komunitetin bankar. Asambleja, me propozim të Komitetit Ekzekutiv, emëroi për herë të parë, Sekretarin e Përgjithshëm të AAB-së, në përputhje me praktikën më të mirë ndërkombëtare. Sekretari i Përgjithshëm është drejtues i nivelit ekzekutiv të Shoqatës dhe ka një rol aktiv në misionin e saj. Gjithashtu në 2005-ën, Asambleja miratoi Statutin e ri të AAB-së, pas diskutimesh profesionale dhe analizash të detajuara, duke konkluduar në një Statut që është njëkohësisht përfaqësues dhe legjitim, jo vetëm në formë, por edhe në përmbajtje.

Komiteti Ekzekutiv dhe Sekretariati i ri i AAB-së përmbushën shumë detyra, të cilat të detajuara mund të gjenden në faqet e këtij raporti, por prej të cilave si më të rëndësishme do të përmendja përpjekjet për aktivizimin e faqes së internetit të AAB-së (www.aab.al) dhe organizimin e suksesshëm të Forumit Ndërballkanit të Shoqatave të Bankave IFBA, në Durrës. Por ajo çka është më e rëndësishme nga të gjitha është se, sot Shoqata jonë po dëgjohet gjithnjë e më shumë e për më tepër po kërkohen prej saj këshilla dhe aprovime.

Unë jam i sigurt se na presin shumë arritje gjatë 2006-ës, midis të cilave krijimi i Zyrës së Informacionit për Kreditë, finalizimi i ligjit të ri për bankat, si dhe krijimi i Komitetit Drejtues Shtet–Privat. Gjithshçka që është arritur e që do të arrihet në të ardhmen sigurisht që është fryt i përkushtimit të anëtarëve të Asamblesë, Komitetit Ekzekutiv dhe Sekretariatit, të cilët i falenderoj përzemërsisht. Unë nuk kam asnjë dyshim që, me një komunitet të tillë elitar, sektori bankar shqiptar do të vazhdojë të jetë mburrja e ekonomisë dhe që AAB-ja do të vijojë të luajë rolin e saj vendimtar.

Përshëndetje të përzemërta,

Seyhan Pencapligil
Kryetar

# *Ngjarje të Rëndësishme*

| | |
|---|---|
| **14 Janar** | *z. Seyhan PENCAPLIGIL, Drejtor i Përgjthshëm i Bankës Kombëtare Tregtare, dhe z. Steven GRUNERUD, Drejtor i Përgjithshëm i Bankës Raiffeisen - Shqipëri, zgjidhen përkatësisht Kryetar dhe zv. Kryetar i Shoqatës Shqiptare të Bankave (AAB).* |
| **16 Mars** | *Emërohet për herë të parë Sekretari i Përgjithshëm i AAB-së, duke shënuar një hap përpara në drejtim të funksionimit të AAB sipas parimeve ndërkombëtare të organizimit të shoqatave të bankave.* |
| **20 Maj** | *AAB organizon Forumin Interballkanik të Shoqatave të Bankave në Durrës.* |
| **01 Qershor** | *AAB zhvendoset tek zyrat qëndrore të BKT-së, si rrjedhojë e rritjes së personelit dhe aktivitetit të saj.* |
| **30 Qershor** | *Mbledhja e Jashtëzakonshme e Asamblesë së AAB-së miraton Statutin e ri të Shoqatës Shqiptare të Bankave.* |
| **02 Nëntor** | *Bëhet aktive faqja e internetit të AAB-së (www.aab.al).* |
| **12 Dhjetor** | *Mbledhja e Jashtëzakonshme e Asamblesë së AAB-së zgjedh anëtarët e rinj të Komitetit Ekzekutiv të AAB-së (një anëtar shtesë, sipas Statutit të ri dhe një tjetër si rrjedhojë e vëndit bosh, pas dorëheqjes së z. Elias FOROS):<br>- z.Edvin LIBOHOVA, Drejtor i Përgjithshëmi i Bankës Popullore dhe<br>- z. Spiro BRUMBULLI, Drejtor Rajonal i Degës në Shqipëri të Bankës Kombëtare të Greqisë.* |

# *Skema Organizative e AAB*



# Komiteti Ekzekutiv i AAB



*Kryetar*

**z. Seyhan PENCAPLIGIL**
**Drejtor i Përgjithshëm**
**BANKA KOMBËTARE TREGTARE**



*Nënkryetar*

**z. Steven GRUNERUD**
**Drejtor Ekzekutiv**
**BANKA RAIFFEISEN – SHQIPËRI**



*Anëtar*

**z. Dimitris FRANGETIS**
**Drejtor i Përgjithshëm**
**BANKA E TIRANËS**



*Anëtar*

**z. Spiro BRUMBULLI**
**Drejtor Rajonal**
**BANKA KOMBËTARE E GREQISË – Dega në Shqipëri**



*Anëtar*

**z. Edvin LIBOHOVA**
**Drejtor i Përgjithshëm**
**BANKA POPULLORE**

# Sekretariati



**z. Elvin MEKA**
**Sekretar i Përgjithshëm**

# Aktiviteti i AAB-së

### *Hyrje*

Gjatë vitit 2005, aktiviteti i Shoqatës Shqiptare të Bankave (AAB) hyri në një fazë të re zhvillimi, me fillimin nga funksionimi të Sekretariatit të AAB. U emërua për herë të parë Sekretari i Përgjithshëm, duke synuar kështu zhvillimin e një institucioni më të kompletuar, duke vendosura bazat për një profil më të lartë profesional brenda vetë AAB.

### *Aktiviteti gjatë 2005*

Aktiviteti i AAB gjatë 2005 u fokusua në shumë problematika dhe organizime, ku më të rëndësishmet mund të përmenden:

## Ekzekutimi i Kolateralit

AAB, mbështetur në sugjerimet dhe opinionet e bankave anëtare, përgatiti një dokument të plotë me të gjitha problematikat ligjore e proceduriale, lidhur me mosfunksionimin e mirë të procedurave të ekzekutimit të kolateralit, si dhe propozimet respektive për këto çështje e problematika. Dokumenti iu dërgua për diskutim dhe shqyrtim të mëtejshëm Ministrisë së Drejtësisë, si pjesë e ndryshimeve të mundshme në Kodit të Procedurës Civile.

## Zyra e Informacionit për Kreditë

Krijimi i Zyrës së Informacionit të Kredive (ZIK) ishte padyshim çështja më e rëndësishme dhe një sfidë për AAB, në përgjigjë të interesit gjithnjë e më të madh të komunitetit bankar, për të përdorur informacionin që mund të ofrohet nga ZIK në të ardhmen, si rrjedhojë e rritjes së konsiderueshme të aktivitetit kredidhënës.



Sekretariati i AAB-së përgatiti një vrojtim të thjeshtë mbi eksperiencat e vendeve të rajonit, duke kontaktuar me disa shoqata bankash të rajonit dhe gjithshtu me disa shoqëri të huaja, të specializuara në ofrimin e shërbimeve dhe zgjidhjeve të tilla (veçanërisht EXPERIAN-SCOREX, E-S). AAB, mbështetur në informacionin e mbledhur, përgatiti një dokument, lidhur me të dhënat bazë (hyrëse & dalëse), të cilat duhet të dërgohen dhe të konsultohen nga bankat tregtare në Shqipëri. Kjo nismë u nxit më tepër nga rëndësia që komuniteti bankar i kushtoi ngritjes së ZIK, nën kujdesin e Bankës së Shqipërisë dhe me mbështetjen e mundshme financiare të vetë komunitetit bankar.

Pas negociatave me E-S, kjo e fundit paraqiti propozimin e parë të biznesit, dhe më tej, u ftua nga AAB për prezantimin në Tiranë të këtij propozimi.

## Nismat Ligjore

### Ligji "Mbi Parandalimin e Pastrimit të Parave"

Sekretariati i AAB-së luajti një rol kyç në procesin e rishikimit të Ligjit "Mbi Parandalimin e Pastrimit të Parave", duke përgatitur propozimet e duhura në këtë drejtim. Konkretisht, Sekretariati i AAB-së organizoi dy takime me përfaqësuesit e Drejtorisë së Përgjithshme të Parandalimit të Pastrimit të Parave (DPPPP), personat përgjegjës të bankave dhe Drejtorët e Tekonologjisë së Informacionit (TI), në të cilat u diskutua rreth ndryshimeve të mundshme në kuadrin rregullator që lidhet me parandalimin e pastrimit të parave si dhe për kompjuterizimin e procedurave raportuese të bankave tek DPPPP.

AAB-ja organizoi më tej, një takim-diskutimi me personat përgjegjës të bankave për parandalimin e pastrimit të parave, në përfundim të të cilit u hartua një projektpropozim me një listë të detajuar ndryshimesh ligjore, të cilat iu propozuan zyrtarisht Ministrisë së Financave, DPPPP dhe gjithashtu iu vunë në dispozicion dhe Bankës së Shqipërisë.

### Udhëzimi i Bankës së Shqipërisë: "Mbi kushtet minimale teknike të mjediseve të punës së subjekteve që licencohen nga Banka e Shqipërisë".

Me një këmbëngulje të vazhdueshme nga ana e Sekretariatit të AAB-së dhe me një bashkëpunim e konsultim intensiv me Departamentin e Mbikëqyrjes të Bankës së Shqipërisë (BSH), u arrit të riformulohej projektudhëzimi i BSH-së: "***Për kushtet minimale teknike të subjekteve që licencohen nga Banka e Shqipërisë"***. Në këtë mënyrë, u bë e mundur të përfshihen në udhëzimin përfundimtar shumica e propozimeve të AAB-së, duke lehtësuar kështu bankat nga shumë detyrime teknike, administrative e të sigurisë.

### Kuadri i Brendshëm Rregullator

#### *Statuti i AAB-së*

Sekretariati i AAB-së rishikoi të gjithë statutin ekzistues, duke realizuar ndryshime dhe plotësime thelbësore, të cilat konsistonin në:

- Funksionimin më të mirë të Mbledhjeve të Asamblesë së Anëtarëve (rendi i ditës, shpeshtësia e mbledhjeve, procesverbalet, etj),
- Rritjen e numrit të anëtarëve të Komitetit Ekzekutiv (KE) në 5 persona,
- Përcaktimin më të saktë të detyrave të KE,
- Futjen e Sekretatiatit si pjesë organike e AAB dhe përcaktimin e detyrave dhe përgjegjësive respektive të tij,
- Parashikimin e dispozitave shtesë, në rast të përfundimit të anëtarësimit në AAB,
- Ndryshimin e llojit të monedhës së kuotës së anëtarësisë,
- Vendosjen e dispozitave, në një rast të shpërndarjes apo të likujdimit të mundshëm të AAB-së, etj.

Në hartimin e këtyre ndryshimeve, AAB u konsultua me statutet e shoqatave të ndryshme të bankave si: Statuti i Federatës Europiane të Bankave (FBE), Shoqata Greke e Bankave, Shoqata Turke e Bankave dhe Statutin e Shoqatës së Bankave të Kosovës (i hartuar nga UNMIK-u).

#### *Rregullorja e AAB-së: "Mbi Procedurat e shpenzimeve të AAB"*

Kjo rregullore e brendshme, e përgatitur nga Sekretariati i AAB-së, ka për qëllim lehtësimin e procedurave, për kryerjen e shpenzimeve dhe investimeve nga vetë Sekretariati i AAB. Kjo rregullore përcakton procedura të detyrueshme për zbatim, për të gjitha blerjet dhe shpenzimet që do të kryhen nga Sekretariati i AAB-së, të nevojshme për kryerjen e aktivitetit të përditshëm të saj.

## Kodi i Etikës Bankare

Si një ndër dokumentet bazë të një shoqate bankash, Sekretariati i AAB-së u angazhua në hartimin e Kodit të Etikës Bankare të AAB-së, duke u mbështetur në kode të ndryshme të etikës bankare, të shoqatave simotra dhe kryesisht tek ato të: Shoqatës Greke të Bankave, Shoqatës Kroate të Bankave, Shoqatës Hungareze të Bankave dhe Shoqatës Qipriote të Bankave Tregtare. AAB synoi të hartonte një Kod Etike Bankare të thjeshtë, duke hedhur kështu themelet e një eksperience krejtësisht të re në këtë drejtim.

## Promovimi & Marketingu

*Faqja e Internetit të AAB-së:* (http://www.aab.al).

AAB lançoi me sukses, në fillim të nëntorit 2005, faqen e saj të internetit: http://www.aab.al (Shqip dhe Anglisht). Sekretariati përgatiti, grumbulloi, klasifikoi dhe përktheu të gjithë dokumentet, materialet dhe të dhënat e nevojshme, për të krijuar një faqe interneti të mirëdizenjuar, të thjeshtë në përdorim, shumë informuese dhe të dobishme për publikun.

## Organizmet e Brendshme dhe Pjesëmarrjet Ndërkombëtare

*Organizimi i Forumit Ndërballkanik të Shoqatave të Bankave ((IFBA), në Shqipëri.*

AAB organizoi për herë të parë në Shqipëri, Mbledhjen e Forumit Ndërballkank të Shoqatave të Bankave më 20 maj 2005, në Durrës (mbledhje një-ditore). Në mbledhje morën pjesë shtatë anëtarë të këtij Forumi: Shqipëria, Qipro, Greqia, Mali i Zi, Rumania, Turqia dhe Sllovenia. Ndër temat më të rendësishme që u diskutuan në këtë takim ishin:

- Shkëmbimi i ideve mbi rolin, krijimin dhe statutin e një shoqate bankash;
- Ristrukturimi i Mbledhjeve të IFBA;
- Rritjen e prezencës së IFBA-së, nëpërmjet miratimit të logos zyrtare, aktivizimin e plotë të faqen së internetit të IFBA-së dhe publikimit të manuali të zgjeruar mbi sistemin bankar dhe financiar të çdo shteti anëtar i IFBA-së.



*Seminare të tjera*

AAB organizoi dhe sponsorizoi vetë, ose në bashkëpunim, seminaret dhe takimet e mëposhtme:

- **Qeraja Financiare – Kuadri Rregullator Ligjor, Fiskal dhe Kontabël** – *18 Maj 2005* (në bashkëpunim me SEED) (bashkëorganizator),

- **Roli i personave përgjegjës të bankave lidhur në parandalimin e pastrimit të parave** – *21-23 qershor 2005* (në bashkëpunim me Bankën e Shqipërisë dhe FSVC) (bashkësponsor),

- **Dita e Komunikimit Biznes–Banka** (Minipanair & Prezantime) – *20 tetor 2005* (në bashkëpunim me Dhomën e Tregtisë dhe Industrisë, Tiranë) (bashkëorganizator),

- **Takim-diskutimi mbi ndryshimet e mundshme në Ligjin "Mbi Parandalimin e Pastrimit të Parave"** – takim me personat përgjegjës të bankave – *7 dhjetor 2005* (në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Parandalimit të Pastrimit të Parave - DPPPP) (organizator, sponsor),

- **Takim-diskutimi mbi mundësinë e kompjuterizimit të proçedurave raportuese tek GDPML** – takim me Drejtorët e TI-së së Bankave – *8 dhjetor 2005* (në bashkëpunim me DPPPP dhe ORACLE) (organizator, sponsor),

- **Shqipëria: Nevoja për Zyrën e Informacionit për Kreditë** – *12 dhjetor 2005* (në bashkëpunim me EXPERIAN-SCOREX) (bashkëorganizator, sponsor).

## *Konferenca e 4rt Ndërkombëtare e Bankës së Shqiërisë*

Me rastin e Konferencës së 4rt Ndërkombëtare të Bankës së Shqipërisë në Durrës, Mars 2005, Kryetari i AAB, z. Seyhan Pencapligil, mbajti një fjalim me temë: "Mbi konkurrencën bankare"[1].

## *"Globalizimi, Konventat Europiane dhe Nismat Kombëtare Kundër Pastrimit të Parave dhe Financimin e Terrorizmit", Konferencë Ndërkombëtare.*

Me rastin e Konferencës Ndërkombëtare: "Globalizimi, Konventat Europiane dhe Nismat Kombëtare Kundër Pastrimit të Parave dhe Financimit të Terrorizmit", në Sofia, të Bullgarisë, 27-28 tetor 2005, kryetari i AAB, z. Seyhan Pencapligil, mbajti një fjalim me temë: "***Pastrimi i Parave dhe Roli i Bankave***"[2].

## *Mbledhja e 20të e Anëtarëve të Asociuar të FBE-së*

AAB u përfaqësua nga Sekretari i Përgjithshëm, në mbledhjen e 20të të rradhës, të anëtarëve të asociuar të FBE-së, në Budapest, HUNGARI, Maj 2005.

## *Forumi Ndërballkanik i Shoqatave të Bankave (IFBA) në Rumani*

AAB u përfaqësua nga Sekretari i Përgjithshëm, në mbledhjen e rradhës të IFBA-së në Bukuresht, RUMANI, ku u diskutuan çështjet e mëposhtme:

- Pas–FSAP-i (Plani i Veprimit lidhur me Shërbimet Financiare),
- Ombudsman-i për shërbimet bankare dhe investimet financiare,
- Zyra e Informacionit për Kreditë,
- Basel II,
- Diskutime mbi bashkëpunimin në fushën e trajnimeve midis shoqatave anëtare,
- Diskutime mbi Manualin e Sistemeve Bankare në Ballkan.



## Financimi i Skemës Sociale të Strehimit

Si pjesëmarrës në grupin e punës për financimin e skemës sociale të strehimit, Sekretariati i AAB përgatiti një dokument ***("Përfshirja e Sektorit Bankar në financimin e skemës sociale të strehimit")***, sipas së cilës propozohen disa skema të përshtatshme financimi për shtresat sociale në nevojë, skema këto u shërbejnë interesave të komunitetit bankar, duke i krijuar atij mundësi më të mëdha kreditimi.

## Të ndryshme

AAB, gjatë aktivitetit të saj, përgatiti dhe një sërë materialesh, si më poshtë:

- **"Manuali i Sistemeve Bankare në Ballkan: *Sistemi Bankar Shqiptar*".**
  Manuali do të japë informacion rreth strukturës dhe profilit të sistemeve bankare të rajonit të Ballkanit. Ky publikim do të synojë të rrisë prezencën e IFBA-së si dhe do të shërbejë si një mjet krahasues i rëndësishëm për sistemet bankare në rajon.

- **E ardhmja e tregut primar (& sekondar) të Bonove të Thesarit për individët.**
  Ky material diskutimi i shkurtër jep disa të dhëna mbi qëndrimin aktual dhe atë të synuar të Bankës së Shqipërisë, lidhur me tregun primar dhe sekondar të Bonove të Thesarit, si dhe propozon disa pika diskutimi, që duhet të kihen parasysh nga bankat tregtare, në drejtim të ofrimit për klientët e tyre të shërbimeve lidhur me invesitmin në Bonot e Thesarit.

---

[1] Kopje e fjalimit mund të gjendet në website-in e AAB: http://www.aab.al/alb/documents/SPBoAConferencePaper.doc

[2] Kopje e fjalimit mund të gjendet në website-in e AAB: http://www.aab.al/alb/documents/MoneyLaunderingSpeechSofia.doc

- **Pastrimi i Parave dhe Sistemi Bankar Shqiptar**.
  Ky dokument përmbledh çështjet më të rendësishme të ndeshura nga komuniteti bankar në Shqipëri, lidhur me parandalimin e pastrimit të parave (paraqitur ekspertëve të BE-së, të angazhuar në çështjen e parandalimit të pastrimit të parave).

- **Formulari i raportimit të të dhënave tremujore të paaudituara të bankave.**
  Ky formular ka për qëllim informimin e publikut të gjërë mbi treguesit kryesorë financiarë te sistemit bankar shqiptar (të publikuara në faqen e internetit të AAB-së).

## *Objektivat për Vitin 2006:*

Për 2006, AAB do të synojë përmbushjen e objektivave dhe prioriteteve të mëposhtme:

- Krijimi i Zyrës së Informacionit për Kreditë, nën kujdesin e Bankës së Shqipërisë;

- Bashkëpunimi i ngushtë me Bankën e Shqipërisë, për hartimin e variantit më të përshtatshëm të ligjit të ri "Për Bankat në Republikën e Shqipërisë";

- Krijimi i "Komitetit Drejtues Shtet-Privat" dhe emërimi i Drejtuesit të Projekteve të Veçanta, për të koordinuar studimet analitike të mikro-reformave të mundshme për sigurimin e një ndërmjetësimi (dialogu) financiar efikas në Shqipëri;

- Krijimi i Akademisë Shqiptare të Bankierëve (qendër trejnimi të bankierëve), në bashkëpunim me NFX[3];

- Promovimi i shërbimeve bankare për publikun e gjerë.



[3] NFX është një platformë, nëpërmjet të cilës Qeveria Hollandeze dhe disa nga bankat më të mëdha hollandeze (ABN Amro, ING Bank, Rabo Bank, Fortis, and FMO), bashkëpunojnë për zgjerimin e aktivitetit të këtyre të fundit në tregjete ekonomitë e reja të tregut.

# *Profili i AAB-së*

***Themeluar:*** 15 Prill 1999




***Adresa:***
SHOQATA SHQIPTARE E BANKAVE
Blvd. "Zhan d'Ark", Selia Qendrore e BKT,
Tiranë, SHQIPËRI
Tel:+355 4 250 955 ext. 889, 890, 891
Fax:+355 4 250 955
E-mail: secretariat@aab-al.org
URL: http://www.aab.al

***Anëtarësimi në Organizata Ndërkombëtare:***
Anëtar i asociuar i FBE – Federata Europiane e Bankave , 2003 www.fbe.be

***Komiteti Ekzekutiv:***
z. Seyhan PENCAPLIGIL, Kryetar
z. Steven GRUNERUD, zv. Kryetar
z. Dimitris FRANGETIS, Anëtar
z. Edvin LIBOHOVA, Anëtar
z. Spiro BRUMBULLI, Anëtar

***Sekretariati:***
z. Elvin MEKA, MBA
Sekretar i Përgjithshëm

***Struktura Organizative*** :
**Forma Ligjore:** Organizatë jofitimprurëse.
**Anëtarësimi:** 16 banka tregtare (vullnetar).

***Anëtarët e Shoqatës Shqiptare të Bankave (AAB)***:

| | | | |
|---|---|---|---|
| | **Banka Alpha** | BANCA ITALO ALBANESE BANKA ITALO SHQIPTARE | **Banka Italo-Shqiptare** |
| | **Banka Amerikane e Shqipërisë** | NBG Bank | **Banka Tregtare e Greqisë – Shqipëri** |
| BANKA CREDINS | **Banka Credins** | BKT | **Banka Kombëtare Tregtare** |
| CBA | **Banka e Kreditit të Shqipërisë** | | **Banka Popullore** |
| Banca Italiana Sviluppo Banka Italiane e Zhvillimit | **Banka Italiane për Zhvillim** | ProCredit Bank | **Banka ProCredit** |
| Emporiki Bank | **Banka Emporiki – Shqipëri** | | **Banka Raiffeisen – Shqipëri** |
| | **Banka e Parë e Investimeve** | TIRANA BANK | **Banka Tirana** |
| | **Banka Ndërkombëtare Tregtare** | UBA | **Banka e Bashkuar e Shqipërisë** |

# Aktiviteti Financiar i AAB

Shoqata Shqiptare e Bankave

Pasqyrat Financiare

31 dhjetor 2005

## Përmbajtja


Bilanci 57
Pasqyra e të Ardhurave dhe Shpenzimeve 58
Pasqyra e Rrjedhës së Parasë 59

Shënime në Pasqyrat Financiare

1. *Informacion i Përgjithshëm* 60
2. *Baza e Përgatitjes* 60
3. *Përmbledhje e Politikave Kontabël* 60
4. *Arka dhe Banka* 61
5. *Aktivet e Qëndrueshme* 61
6. *Kuotat e Anëtarësisë* 62
7. *Interesat Bankare* 62
8. *Të Ardhura të Tjera* 62
9. *Amortizimi i Akumuluar* 62
10. *Shpenzimet e Përgjithshme dhe ato të Administrimit* 63
11. *Diferencat nga Kursi i Këmbimit* 63

| | *Shënimi* | *31 dhjetor 2005* | *31 dhjetor 2004* |
|---|---|---|---|
| **Aktivet** | | | |
| Arka dhe Banka | 4 | 2,636,480 | 593,173 |
| **Totali i Aktiveve Afatshkurtra** | | 2,636,480 | 593,173 |
| **Aktivet Afatgjata** | | | |
| Aktivet e qëndrueshme, neto | 5 | 991,767 | 398,223 |
| **Totali i Aktiveve Afatgjata** | | 991,767 | 398,223 |
| **Totali i Mjeteve** | | **3,628,247** | **991,396** |
| Aktivet Neto | | 3,628,247 | 991,396 |
| **Totali i Detyrimeve dhe Aktiveve Neto** | | **3,628,247** | **991,396** |

Bilanci duhet të lexohet së bashku me shënimet përkatëse 4 deri 11, si pjesë e pasqyrave financiare.

Pasqyrat Financiare të Shoqatës Shqiptare të Bankave (AAB) janë përpiluar dhe nxjerrë në datë 17.07.2006 dhe nënshkruar në emër të AAB-së nga:

| | |
|---|---|
| Elvin MEKA<br>Sekretar i Përgjithshëm<br>SHOQATA<br>SHQIPTARE E BANKAVE | Ilir PRIFTI<br>Shef i Financës<br>Dega në Tiranë e<br>ALPHA BANK A.E |

## Shoqata Shqiptare e Bankave

### Pasqyra e Të Ardhurave dhe Shpenzimeve në datë 31 dhjetor 2005 dhe 31 dhjetor 2004

*(në LEK)*

| | *Shënimi* | *31 dhjetor 2005* | *31 dhjetor 2004* |
|---|---|---|---|
| **Të Ardhurat** | | | |
| Kuotat e Anëtarësisë | 6 | 8,371,578 | 3,501,792 |
| Interesat Bankare | 7 | 11,975 | 1,255 |
| Të Ardhura të Tjera | 8 | 124,296 | - |
| Totali i të Ardhurave | | **8,507,849** | **3,503,047** |
| **Shpenzimet** | | | |
| Amortizimi i Akumuluar | 9 | 156,162 | 59,123 |
| Shpenzimet e Përgjithshme dhe të Administrimit | 10 | 5,678,004 | 5,339,744 |
| Diferencat nga Kursi i Këmbimit | 11 | 36,832 | 39,026 |
| Totali i Shpenzimeve | | **5,870,998** | **5,437,893** |
| Teprica/(Deficiti) i të Ardhurave ndaj Shpenzimeve | | **2,636,851** | **(1,934,846)** |
| **Aktivet Neto në fillim të vitit** | | **991,396** | **2,926,242** |
| **Aktivet Neto në fund të vitit** | | **3,628,247** | **991,396** |

Pasqyra e të Ardhurave dhe Shpenzimeve duhet të lexohet së bashku me shënimet përkatëse 4 deri 11, si pjesë e pasqyrave financiare.

## Shoqata Shqiptare e Bankave

### Pasqyra e Rrjedhës së Parasë në datë 31 dhjetor 2005 dhe 31 dhjetor 2004

*(në LEK)*

| | *Shënimi* | *31 dhjetor 2005* | *31 dhjetor 2004* |
|---|---|---|---|
| **Rrjedha e Parasë nga Akivitetet Operacionale** | | | |
| Teprica/(Deficiti) e të Ardhurave ndaj Shpenzimeve | | 2,636,851 | (1,934,846) |
| *Rregullime për:* | | | |
| Amortizimin | | 156,162 | 59,123 |
| Teprica e Parave nga Aktivitetet Operaionale | | 2,793,013 | (1,875,723) |
| **Investimet** | | | |
| Blerje të Aktiveve të Qëndrueshme | | 749,706 | 457,346 |
| Rrjedha e Parasë nga Aktivitetet Investuese | | 749,706 | 457,346 |
| **Rritja Neto në Rrjedhën e Parave** | | **2,043,307** | **(2,333,069)** |
| **Arka dhe Banka në Fillim të Vitit** | | **593,173** | **2,926,242** |
| **Arka dhe Banka në Fund të Vitit** | 4 | **2,636,480** | **593,173** |

Pasqyra e rrjedhës së Parave duhet të lexohet së bashku me shënimet përkatëse 4 deri 11, si pjesë e pasqyrave financiare.

## 1. Informacion i Përgjithshëm

Shoqata Shqiptare e Bankave (AAB) është themeluar në 15 prill 1999 me seli në pranë Selisë Qendrore të Bankës Kombëtare Tregtare, në bulevardin "Zhan d'Ark" Tiranë, Shqipëri.

Shoqata Shqipatare e Bankave (AAB) është një shoqatë jo-fitimprurëse, e cila përpiqet të promovojë standardet më të fundit bankare të anëtarëve të saj, zhvillimin, stabilitetin dhe efektshmërinë e sistemit bankar shqiptar në përgjithësi, duke kontribuar kështu në përparimin e ekonomisë shqiptare. AAB përbëhet nga shtatëmbëdhjetë anëtarë, mbi baza vullnetare: Alpha Bank – Dega në Shqipëri, Banka Amerikane e Shqipërisë, Banka Credins, Banka Emporiki – Shqipëri, Banka Italiane e Zhvillimit, Banka Italo-Shqiptare, Banka Kombëtare e Greqisë – Dega në Shqipëri, Banka Kombëtare Tregtare, Banka e Kreditit të Shqipërisë, Banka Ndërkombëtare Tregtare, Banka e Parë e Investimeve – Shqipëri, Banka Popullore, Banka ProCredit, Banka e Tiranës, Raiffeisen Bank – Shqipëri, Banka Union, Banka e Bashkuar e Shqipërisë[4].

## 2. Baza e Përgatitjes

Librat dhe regjistrimet kontabël të AAB mbahen sipas një modeli të modifikuar të kontabilitetit me bazë *cash*-i. Konkretisht, të ardhurat njihen si të tilla pasi arkëtohen dhe jo kur konstatohen dhe shpenzimet njihen kur paguen dhe jo kur kryhen, me përjashtim të veprimeve lidhur me pajisjet dhe tokat dhe ndërtesat, të cilat kapitalizohen dhe amortizohen gjatë gjithë periudhës së pritshme të përdorimit.

## 3. Përmbledhje e Politikave Kontabël

### *3.1 Njohja e të Ardhurave dhe Shpenzimeve*

Të ardhurat regjistrohen kur arkëtohen dhe shpenzimet kur paguhen.

### *3.2 Aktivet e Qëndrueshme*

Aktivet e qëndrueshme mbahen me kosto, minus amortizimin e akumuluar. Amortizimi kryhet sipas metodës lineare, duke shpërndarë koston e pasurisë dhe të pajisjeve, përgjatë gjithë periudhës së pritshme të përdorimit të tyre. Amortizimi fillon të regjistrohet që nga muaji pasardhës i atij të blerjes, me normat e mëposhtme:

| | *Në %* |
|---|---|
| Mobilje | 20 |
| Pajisjet Elektronike | 25 |

### *3.3 Konvertimi nga monedha e huaj*

AAB përdor si monedhë bazë LEK-un (ALL). Të gjithë kontributet dhe pjesa dërrmuese e shpenzimeve janë në Dollarë Amerikanë (USD). Transaksionet në monedhë të huaj konvertohen në LEK me një kurs që i përafrohet atij të datës së kryerjes së transaksionit. Aktivet dhe pasivet janë konvertuar në LEK, duke përdorur kursin e këmbimit të AAB, i cili është i përafërt me kursin e Bankës së Shqipërisë. Diferencat nga kursi i këmbimit janë regjistruar në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

### *3.4 Tatimet dhe Taksat*

AAB është një shoqatë jofitimprurëse dhe si e tillë është e përjashtuar nga tatimi mbi fitimin në Shqipëri. AAB është subjekt i tatimit në burim, i tatimit mbi të ardhurat personale dhe i kontributeve të sigurimeve shoqërore.

---

[4] Sipas rendit alfabetik në Anglisht.

## 4. Arka dhe Banka

Arka dhe banka përbëhen nga sa më poshtë:

| | 31 dhjetor 2005 | 31 dhjetor 2004 |
|---|---|---|
| Arka | 57,241 | 12,949 |
| Banka | 2,579,239 | 580,224 |
| | **2,636,480** | **593,173** |

Arka përbëhet nga sa më poshtë:

| | 31 dhjetor 2005 | 31 dhjetor 2004 |
|---|---|---|
| *Llogaria korente:* | | |
| Në LEK | 1,347,174 | - |
| Në USD | 11,894.82 | 68,263.21 |

## 5. Aktivet e Qëndrueshme

Aktivet e qëndrueshme përbëhen nga sa më poshtë:

| | Orendi | Pajisje Elektronike | TOTALI |
|---|---|---|---|
| *Kosto* | | | |
| Në 31 dhjetor 2004 | **285,073** | **172,273** | **457,346** |
| Shtesat gjatë vitit | 303,494 | 446,212 | 749,706 |
| Pakësimet gjatë vitit | - | - | - |
| Në 31 dhjetor 2005 | 588,567 | 618,485 | 1,207,052 |
| *Amortizimi i Akumuluar* | | | |
| Në 31 dhjetor 2004 | 30,410 | 28,713 | 59,123 |
| Amortizimi gjatë vitit | 71,280 | 84,882 | 156,162 |
| Pakësimet gjatë vitit | - | - | - |
| Në 31 dhjetor 2005 | 101,690 | 113,595 | 215,285 |
| *Vlera Neto e Librit* | | | |
| **Në 31 dhjetor 2004** | **254,663** | **143,560** | **398,223** |
| **Në 31dhjetor 2005** | **486,877** | **504,890** | **991,767** |

## 6. Kuotat e Anëtarësimit

Të ardhurat e arkëtuara gjatë 2005 dhe 2004 janë si vijon:

| | *2005* | *2004* |
|---|---|---|
| Kuotat e anëtarësimit në LEK | 2,250,000 | - |
| Kuotat e anëtarësimit në Monedhë të Huaj | 6,121,578 | 3,501,792 |
| **Totali** | **8,371,578** | **3,501,792** |

## 7 Interesat Bankare

Interesat bankare përfshijnë:

| | *2005* | *2004* |
|---|---|---|
| Interesat nga llogaritë korente në LEK | 5,760 | - |
| Interesat nga llogaritë korente në Monedhë të Huaj | 6,215 | 1,255 |
| | **11,975** | **1,255** |

## 8 Të Ardhura të Tjera

Të ardhurat e tjera detajohen si vijon:

| | *31 dhjetor 2005* | *31 dhjetor 2004* |
|---|---|---|
| Kuotat e pranimit | 124,296 | - |
| | **124,296** | |

## 9 Amortizimi i Akumuluar

| | *2005* | *2004* |
|---|---|---|
| Amortizimi i akumuluar për pajisjet elektronike | 84,882 | 28,713 |
| Amortizimi i akumuluar për pajisjet e zyrës | 71,280 | 30,410 |
| | **156,162** | **59,123** |

## 10 Shpenzimet e Përgjithshme dhe të Administrimit

Shpenzimet e përgjithshme dhe të administrimit në 2005 dhe 2004 përbëhen nga sa vijon:

| | *2005* | *2004* |
|---|---|---|
| Pagat | 2,758,965 | 852,288 |
| Sigurime Shoqërore & Tatime mbi të Ardhurat Personale & të Tjera | 533,866 | |
| Shpenzime Qeraje | 299,259 | 278,234 |
| Shpenzime Anëtarësie | 461,331 | 366,595 |
| Shpenzime për Udhëtime Pune | 241,447 | 920,229 |
| Shpenzime për Argëtim | 676,342 | 155,327 |
| Shpenzime për Reklama & Internet | 67,096 | 1,434,260 |
| Taksa Vendore | 47,872 | - |
| Mjete Zyre dhe Sërbime Utilitare | 135,338 | 186,736 |
| Shpenzime të Tjera | 436,376 | 1,138,650 |
| Shpenzime për Komisione Bankare | 20,112 | 7,425 |
| | **5,678,004** | **5,339,744** |

## 11 Diferencat nga Kursi i Këmbimit

Diferencat nga kursi i këmbimit në 2005 dhe 2004, janë si vijon:

| | *2005* | *2004* |
|---|---|---|
| Diferencat nga Kursi i Këmbimit | 36,832 | 39,026 |
| | **36,832** | **39,026** |

# ALPHA BANK - Shqipëri



z. Andreas Galatoulas
Drejtor i Përgjithshëm




**Alpha Bank – Shqipëri**
Bulevardi "Zogu i Parë", No. 47,
Tiranë, SHQIPERI
Tel: +355 4 240 476/233 359
Fax: +355 4 232 102
http://www.alpha.gr

| | LEK | EURO |
|---|---|---|
| ***Mjetet*** | ***28,744,333,353*** | ***234,494,480*** |
| ***Huatë*** | ***13,428,174,686*** | ***109,546,212*** |
| *- Huatë për Biznes* | *10,500,229,245* | *85,660,216* |
| *- Huatë për Individë* | *2,927,945,441* | *23,885,996* |
| ***Kapitali Aksioner*** | ***2,832,543,827*** | ***23,107,716*** |
| ***Depozitat*** | ***21,790,575,794*** | ***177,766,159*** |
| *- Depozitat e Bizneseve* | *5,719,448,352* | *46,658,903* |
| *- Depozitat e Individëve* | *16,071,127,442* | *131,107,256* |
| ***Fitimi Neto*** | ***803,780,000*** | ***6,557,187*** |

*1 EUR = 122.58 ALL*

| | |
|---|---|
| ***Nr. i degëve dhe agjencive*** | ***8*** |
| ***Nr. i punonjësve*** | ***85*** |

# BANKA AMERIKANE E SHQIPERISE



*z. Lorenzo RONCARI*
*President & Drejtor Ekzekutiv*






**Banka Amerikane e Shqipërisë**
Rruga "Ismail Qemali", Nr. 27,
Kutia Postare Nr.8319,
Tiranë, SHQIPERI
Tel: +355 4 276 103
Fax: +355 4 237 570
http://www.albambank.com

| | LEK | EURO |
|---|---|---|
| **Mjetet** | **55,757,170,348** | **454,863,521** |
| **Huatë** | **21,004,677,460** | **171,354,850** |
| - Huatë për Biznes | | |
| - Huatë për Individë | | |
| **Kapitali Aksioner** | **3,446,210,180** | **28,113,968** |
| **Depozitat** | **47,045,932,420** | **383,797,784** |
| - Depozitat e Bizneseve | | |
| - Depozitat e Individëve | | |
| **Fitimi Neto** | **623,240,860** | **5,084,360** |

*1 EUR = 122.58 ALL*
*1 US$ = 103.58 ALL*

| | |
|---|---|
| **Nr. i degëve dhe agjencive** | **15** |
| **Nr. i punonjësve** | **362** |

# BANKA CREDINS



z. Artan SANTO
Drejtor i Përgjithshëm




BANKA CREDINS



**Banka Credins**
Rruga "Ismail Qemali", Nr. 21,
Tiranë, SHQIPERI
Tel: +355 4 258 252, 234 096
Fax: +355 4 222 916
http://www.bankacredins.com

| | LEK | EURO |
|---|---|---|
| ***Mjetet*** | ***16,791,919,047*** | ***136,987,429*** |
| ***Huatë*** | ***6,148,633,026*** | ***50,160,165*** |
| *- Huatë për Biznes* | *5,741,653,452* | *46,840,051* |
| *- Huatë për Individë* | *406,979,452* | *3,320,113* |
| ***Kapitali Aksioner*** | ***1,099,414,136*** | ***8,968,952*** |
| ***Depozitat*** | ***14,681,658,012*** | ***119,772,051*** |
| *- Depozitat e Bizneseve* | *4,941,465,921* | *40,312,171* |
| *- Depozitat e Individëve* | *9,740,192,090* | *79,459,880* |
| ***Fitimi Neto*** | ***75,273,681*** | ***614,078*** |

*1 EUR = 122.58 ALL*

| | |
|---|---|
| ***Nr. i degëve dhe agjencive*** | ***7*** |
| ***Nr. i punonjësve*** | ***113*** |

# BANKA E KEDITIT E SHQIPERISE



*z. Kamal Abdel Moneim ALY*
*Drejtor Ekzekutiv*




**Banka e Kreditit e Shqipërisë**
Rruga "Perlat Rexhepi",
Ndrtesa Administrative e
Al Kharafi Group, Kati 1& 2,
Tiranë, SHQIPERI
Tel: +355 4 272 168
Fax: +355 4 258 752
http://www.creditbankofalbania.com.al

| | LEK | EURO |
|---|---|---|
| ***Mjetet*** | ***1,613,336,000*** | ***13,161,741*** |
| ***Huatë*** | ***324,923,000*** | ***2,650,699*** |
| *- Huatë për Biznes* | *283,668,000* | *2,314,146* |
| *- Huatë për Individë* | *41,255,000* | *336,553* |
| ***Kapitali Aksioner*** | ***799,529,000*** | ***6,552,506*** |
| ***Depozitat*** | ***787,360,000*** | ***6,423,232*** |
| *- Depozitat e Bizneseve* | *732,870,000* | *5,978,712* |
| *- Depozitat e Individëve* | *54,490,000* | *444,520* |
| ***Fitimi Neto*** | ***-6,377,000*** | ***-52,022*** |

*1 EUR = 122.58 ALL*

| | |
|---|---|
| ***Nr. i degëve dhe agjencive*** | ***2*** |
| ***Nr. i punonjësve*** | ***28*** |

# EMPORIKI BANK - Shqipëri



*z. George CARACOSTAS*
*Drejtor i Përgjithshëm*






**Emporiki Bank – Shqipëri**
"Rruga "Kavajës"
Tirana Tower,
Tiranë, SHQIPERI
Tel: +355 4 258 755
Fax: +355 4 258 752
http://www.emporiki.gr

| | LEK | EURO |
|---|---|---|
| ***Mjetet*** | ***7,532,812,911*** | ***61,452,218*** |
| ***Huatë*** | ***5,149,324,150*** | ***42,007,866*** |
| *- Huatë për Biznes* | *3,983,286,377* | *32,495,402* |
| *- Huatë për Individë* | *1,166,037,773* | *9,512,464* |
| ***Kapitali Aksioner*** | ***1,288,512,293*** | ***10,511,603*** |
| ***Depozitat*** | ***3,941,991,201*** | ***32,158,519*** |
| *- Depozitat e Bizneseve* | *1,489,556,489* | *12,151,709* |
| *- Depozitat e Individëve* | *2,452,434,712* | *20,006,810* |
| ***Fitimi Neto*** | ***110,777,541*** | ***903,716*** |

*1 EUR = 122.58 ALL*

| | |
|---|---|
| ***Nr. i degëve dhe agjencive*** | ***3*** |
| ***Nr. i punonjësve*** | ***60*** |

# FIRST INVESTMENT BANK - Shqipëri



*z. Martin BOGDANOV*
*Drejtor i Përgjithshëm*




**First Investment Bank – Shqipëri**
Bulevardi "Zogu i Parë", Nr. 64,
Tiranë, SHQIPERI
Tel: +355 4 256 423
Fax: +355 4 256 422
http://www.fibank.bg

| | LEK | EURO |
|---|---|---|
| ***Mjetet*** | ***1,779,313,000*** | ***14,515,525*** |
| ***Huatë*** | ***122,302,906*** | ***997,739*** |
| *- Huatë për Biznes* | *105,691,953* | *862,228* |
| *- Huatë për Individë* | *16,610,953* | *135,511* |
| ***Kapitali Aksioner*** | ***792,242,000*** | ***6,463,061*** |
| ***Depozitat*** | ***714,493,551*** | ***5,828,794*** |
| *- Depozitat e Bizneseve* | *243,005,943* | *1,982,427* |
| *- Depozitat e Individëve* | *471,487,608* | *3,846,367* |
| ***Fitimi Neto*** | ***20,120,065*** | ***164,138*** |

*1 EUR = 122.58 ALL*

| | |
|---|---|
| ***Nr. i degëve dhe agjencive*** | ***2*** |
| ***Nr. i punonjësve*** | ***28*** |

# BANKA NDERKOMBETARE TREGTARE



*z. Ooi Kooi KEAT*
*Drejtor i Përgjithshëm*







**Banka Ndërkombëtare Tregtare**
Rruga "Murat Toptani"
Pranë "Gjergji Center",
Tiranë, SHQIPERI
Tel: +355 4 254 372/256 254
Fax: +355 4 254 386
http://www.icbankingroup.com


| | LEK | EURO |
|---|---|---|
| ***Mjetet*** | ***3,118,000,000*** | ***25,436,450*** |
| ***Huatë*** | ***1,502,000,000*** | ***12,253,222*** |
| *- Huatë për Biznes* | | |
| *- Huatë për Individë* | | |
| ***Kapitali Aksioner*** | ***830,000,000*** | ***6,771,088*** |
| ***Depozitat*** | ***2,179,800,000*** | ***17,782,673*** |
| *- Depozitat e Bizneseve* | | |
| *- Depozitat e Individëve* | | |
| ***Fitimi Neto*** | ***15,100,000*** | ***123,185*** |

*1 EUR = 122.58 ALL*

| | |
|---|---|
| ***Nr. i degëve dhe agjencive*** | ***4*** |
| ***Nr. i punonjësve*** | ***54*** |

# BANKA ITALO - SHQIPTARE



z. Giovanni BOGANI
Drejtor i Përgjithshëm



BANCA ITALO ALBANESE
BANKA ITALO SHQIPTARE

**Banka Italo - Shqiptare**
Rruga "Barrikadave", No. 70,
Tiranë, SHQIPERI
Tel: +355 4 233 965
Fax: +355 4 235 700
http://www.bia.com.al

| | LEK | EURO |
|---|---|---|
| ***Mjetet*** | ***19,332,463,310*** | ***157,713,031*** |
| ***Huatë*** | ***4,725,673,780*** | ***38,551,752*** |
| *- Huatë për Biznes* | | |
| *- Huatë për Individë* | | |
| ***Kapitali Aksioner*** | ***2,219,628,919*** | ***18,107,594*** |
| ***Depozitat*** | ***16,035,028,263*** | ***130,812,761*** |
| *- Depozitat e Bizneseve* | | |
| *- Depozitat e Individëve* | | |
| ***Fitimi Neto*** | ***480,067,175*** | ***3,916,358*** |

*1 EUR = 122.58 ALL*

| | |
|---|---|
| ***Nr. i degëve dhe agjencive*** | ***3*** |
| ***Nr. i punonjësve*** | ***71*** |

# BANKA ITALIANE E ZHVILLIMIT



*z. Libero CATALANO*
*Drejtor i Përgjithshëm*




**Banka Italiane e Zhvillimit**
Bulevardi "Dëshmorët e Kombit",
Tiranë, SHQIPERI
Tel: +355 4 228 759
Fax: +355 4 230 566



| | LEK | EURO |
|---|---|---|
| ***Mjetet*** | ***1,282,369,000*** | ***14,515,525*** |
| ***Huatë*** | ***0*** | ***0*** |
| *- Huatë për Biznes* | *0* | *0* |
| *- Huatë për Individë* | *0* | *0* |
| ***Kapitali Aksioner*** | ***965,317,000*** | ***7,875,000*** |
| ***Depozitat*** | ***313,727,000*** | ***2,559,365*** |
| *- Depozitat e Bizneseve* | *75,548,000* | *616,316* |
| *- Depozitat e Individëve* | *238,179,000* | *1,943,049* |
| ***Fitimi Neto*** | ***-143,803,000*** | ***-1,173,143*** |

*1 EUR = 122.58 ALL*

| | |
|---|---|
| ***Nr. i degëve dhe agjencive*** | ***1*** |
| ***Nr. i punonjësve*** | ***16*** |

# BANKA KOMBETARE E GREQISE – Shqipëri



*z. Spiro BRUMBULLI*
*Drejtor Rajonal*




**Banka Kombëtare e Greqisë – Shqipëri**
Rruga "Durrësit",
Tiranë, SHQIPERI
Tel: +355 4 233 621
Fax: +355 4 233 613
http://www.nbg.gr


| | LEK | EURO |
|---|---|---|
| ***Mjetet*** | ***12,511,116,000*** | ***102,065,000*** |
| ***Huatë*** | ***8,201,575,000*** | ***66,908,000*** |
| *- Huatë për Biznes* | *2,317,799,000* | *18,908,000* |
| *- Huatë për Individë* | *5,883,776,000* | *48,000,000* |
| ***Kapitali Aksioner*** | ***948,949,000*** | ***7,742,000*** |
| ***Depozitat*** | ***8,619,561,000*** | ***70,318,000*** |
| *- Depozitat e Bizneseve* | *1,275,231,000* | *10,403,000* |
| *- Depozitat e Individëve* | *7,344,330,000* | *59,915,000* |
| ***Fitimi Neto*** | ***160,710,000*** | ***1,311,000*** |

*1 EUR = 122.58 ALL*

| | |
|---|---|
| ***Nr. i degëve dhe agjencive*** | ***6*** |
| ***Nr. i punonjësve*** | ***89*** |

# BANKA KOMBETARE TREGTARE



*z. Seyhan PENCAPLIGIL*
*Drejtor i Përgjithshëm*





**Banka Kombëtare Tregtare**
Bulevardi "Zhan D'Ark",
Tiranë, SHQIPERI
Tel: +355 4 250 955
Fax: +355 4 250 956
http://www.bkt.com.al

| | LEK | EURO |
|---|---|---|
| ***Mjetet*** | ***61,136,978,810*** | ***498,751,663*** |
| ***Huatë*** | ***13,084,063,622*** | ***106,738,975*** |
| *- Huatë për Biznes* | *10,018,199,281* | *81,727,845* |
| *- Huatë për Individë* | *3,065,864,341* | *25,011,130* |
| ***Kapitali Aksioner*** | ***3,391,917,451*** | ***27,671,051*** |
| ***Depozitat*** | ***57,086,217,532*** | ***465,705,805*** |
| *- Depozitat e Bizneseve* | *13,005,800,532* | *106,100,510* |
| *- Depozitat e Individëve* | *44,080,417,000* | *359,605,295* |
| ***Fitimi Neto*** | ***817,625,406*** | ***6,670,137*** |

*1 EUR = 122.58 ALL*

| | |
|---|---|
| ***Nr. i degëve dhe agjencive*** | ***26*** |
| ***Nr. i punonjësve*** | ***375*** |

# BANKA POPULLORE



*z. Edvin LIBOHOVA*
*Drejtor i Përgjithshëm*




**Banka Popullore**
Rruga "Donika Kastrioti",
EGT Tower, nr.11/1,
Tiranë, SHQIPERI
Tel: +355 4 272 790/791
Fax: +355 4 272 78
http://www.bpopullore.com

| | LEK | EURO |
|---|---|---|
| ***Mjetet*** | ***15,325,231,000*** | ***125,022,279*** |
| ***Huatë*** | ***7,913,376,000*** | ***64,556,828*** |
| *- Huatë për Biznes* | *5,137,467,000* | *41,911,135* |
| *- Huatë për Individë* | *2,775,909,000* | *22,645,693* |
| ***Kapitali Aksioner*** | ***1,069,300,000*** | ***8,723,283*** |
| ***Depozitat*** | ***13,835,904,000*** | ***112,872,442*** |
| *- Depozitat e Bizneseve* | *2,387,575,000* | *19,477,688* |
| *- Depozitat e Individëve* | *11,448,329,000* | *93,394,754* |
| ***Fitimi Neto*** | ***28,799,000*** | ***234,940*** |

*1 EUR = 122.58 ALL*

| | |
|---|---|
| ***Nr. i degëve dhe agjencive*** | ***23*** |
| ***Nr. i punonjësve*** | ***206*** |

# BANKA PROCREDIT



z. Ralf REITEMEIER
Drejtor i Përgjithshëm






**Banka ProCredit**
Rruga "Sami Frashëri",
Kutia Postare Nr.2395,
Tiranë, SHQIPERI
Tel: +355 4 271 272
Fax: +355 4 271 276
http://www.procreditbank.com.al

| | LEK | EURO |
|---|---|---|
| ***Mjetet*** | ***23,454,436,000*** | ***191,339,000*** |
| ***Huatë*** | ***9,747,345,000*** | ***79,518,000*** |
| *- Huatë për Biznes* | | |
| *- Huatë për Individë* | | |
| ***Kapitali Aksioner*** | ***2,201,212,000*** | ***17,957,000*** |
| ***Depozitat*** | ***19,592,189,000*** | ***159,832,000*** |
| *- Depozitat e Bizneseve* | | |
| *- Depozitat e Individëve* | | |
| ***Fitimi Neto*** | ***334,055,000*** | ***2,725,000*** |

*1 EUR = 122.58 ALL*

| | |
|---|---|
| ***Nr. i degëve dhe agjencive*** | ***17*** |
| ***Nr. i punonjësve*** | ***489*** |

# BANKA RAIFFEISEN - Shqipëri



z. Steven GRUNERUD
Drejtor Ekzekutiv






**Banka Raiffeisen – Shqipëri**
Rruga “Kavajës”, No. 6,
Tiranë, SHQIPERI
Tel: +355 4 223 695
Fax: +355 4 250 956
http://www.raiffeisen.al

| | LEK | EURO |
|---|---|---|
| ***Mjetet*** | ***202,517,390,000*** | ***1,652,124,245*** |
| ***Huatë*** | ***16,930,161,000*** | ***138,115,198*** |
| *- Huatë për Biznes* | *10,752,630,000* | *87,719,285* |
| *- Huatë për Individë* | *6,177,531,000* | *50,395,913* |
| ***Kapitali Aksioner*** | ***6,859,359,000*** | ***55,958,223*** |
| ***Depozitat*** | ***193,639,483,209*** | ***1,579,698,835*** |
| *- Depozitat e Bizneseve* | *6,811,553,540* | *55,568,229* |
| *- Depozitat e Individëve* | *186,827,929,669* | *1,524,130,606* |
| ***Fitimi Neto*** | ***2,575,424,000*** | ***21,010,148*** |

*1 EUR = 122.58 ALL*

| | |
|---|---|
| ***Nr. i degëve dhe agjencive*** | ***86*** |
| ***Nr. i punonjësve*** | ***1,089*** |

# BANKA E TIRANES



*z. Dimitris FRANGETIS*
*Drejtor i Përgjithshëm*





**Tirana Bank**

Tirana Bank
Rruga "Dëshmorët e 4 Shkurtit"
Tiranë, SHQIPERI
Tel: +355 4 269 430
Fax: +355 4 247 140
http://www.tiranabank.net

| | LEK | EURO |
|---|---|---|
| **Mjetet** | **40,368,425,000** | **329,323,000** |
| **Huatë** | **16,304,827,000** | **133,013,000** |
| - Huatë për Biznes | 11,834,915,000 | 96,548,000 |
| - Huatë për Individë | 4,469,912,000 | 36,465,000 |
| **Kapitali Aksioner** | **2,165,855,000** | **17,669,000** |
| **Depozitat** | **35,064,605,000** | **286,055,000** |
| - Depozitat e Bizneseve | 6,126,978,000 | 49,983,000 |
| - Depozitat e Individëve | 28,937,627,000 | 236,071,000 |
| **Fitimi Neto** | **417,744,000** | **3,408,000** |

1 EUR = 122.58 ALL

| | |
|---|---|
| **Nr. i degëve dhe agjencive** | **32** |
| **Nr. i punonjësve** | **349** |

# BANKA E BASHKUAR E SHQIPERISE



*z. Abdel Waheed ALAVI*
*Drejtor i Përgjithshëm*






**Banka e Bashkuar e Shqipërisë**
Bulevardi "Dëshmorët e Kombit",
No. 8, Tiranë, SHQIPERI
Tel: +355 4 228 387
Fax: +355 4 228 460

| | LEK | EURO |
|---|---|---|
| ***Mjetet*** | ***4,041,136,490*** | ***32,967,340*** |
| ***Huatë*** | ***1,633,502,730*** | ***13,326,013*** |
| *- Huatë për Biznes* | *1,272,307,190* | *10,379,403* |
| *- Huatë për Individë* | *361,195,540* | *2,946,611* |
| ***Kapitali Aksioner*** | ***1,235,097,690*** | ***10,075,850*** |
| ***Depozitat*** | ***2,527,829,840*** | ***20,621,878*** |
| *- Depozitat e Bizneseve* | *407,435,940* | *3,323,837* |
| *- Depozitat e Individëve* | *2,120,393,900* | *17,298,041* |
| ***Fitimi Neto*** | ***109,376,940*** | ***892,290*** |

*1 EUR = 122.58 ALL*

| | |
|---|---|
| ***Nr. i degëve dhe agjencive*** | 3 |
| ***Nr. i punonjësve*** | 55 |